



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada - Government**

***Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural  
Development***

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe nenin 8, paragrafi 15 dhe neni 12 paragrafi 2 pika 5 të Ligjit Nr. 2003/5 për farëra të dt. 15 Prill 2003, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.11/2008**  
**Për Njohjen dhe Pranimin e Kultivarëve të Drithërave të Bardha**

**Neni 1**

**Qëllimi**

1. Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet mënyra e hulumtimit të kultivarëve të drithërave të bardha grurit, elbit, thekrës, tritikaleve dhe tërshërës në fushat testuese dhe laboratorë, përpunimin i të dhënave statistikore me qëllim të njohjes dhe pranimit të kultivarëve të huaj ne Listën e Lejuar të Kosovës.
2. Me hulumtimin e kultivarëve në fushat testuese dhe laboratorë përcaktohet vlera kultivuese dhe përdoruese – VKP e kultivarëve siç janë: rendimenti, lagështia e kokrrës, qëndrueshmëria ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

Termet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto domethënie:

- “**autoritet kompetent**” nënkupton Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve;  
“**inspektor fitosanitar**” nënkupton inspektorin e autorizuar nga ana e autoritetit kompetent;  
“**institucioni i autorizuar**” nënkupton institucionin e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;  
“**VKP**” nënkupton vlerën kultivuese dhe përdoruese të varieteteve për testim;  
“**ISTA**” nënkupton institucionin ndërkombëtar për testimin e farës;  
“**OECD**” nënkupton Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

**Neni 3**

Kërkesa për testimin e kultivarëve i parashtrahet Departamentit të Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve – Seksionit të farëra për farëra, deri më:

- a) 10. shtator për kultivarët dimërorë të grurit, elbit, thekrës, tritikaleve dhe tërshërës,
- b) 10. janar për kultivarët pranverore të grurit, elbit, thekrës, tritikaleve dhe tërshërës.

#### **Neni 4**

Hulumtimi i kultivarëve në fushat eksperimentale zgjat dy vite të cilat i kryen Instituti e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 5**

1. Për çdo vit të hulumtimit, parashtruesi i kërkesës do ti vej në dispozicion sasirat e caktuara të farës në afatet e caktuara kohore si:

<b>Lloji</b>	<b>Sasia e nevojshme e farës (kg)</b>	<b>Afati i dorëzimit të farës</b>
Gruri dimërorë	10	deri 25. shtator
Gruri pranverorë	5	deri 25. janar
Elbi dimërorë dhe pranverorë	7	deri 25. shtator-janar
Thekra dimërore dhe pranverore	7	deri 25. shtator-janar
Tritikale dimërorë dhe pranverorë	7	deri 25. shtator-janar
Tërshëra dimërore dhe pranverore	7	deri 25. shtator-janar

2. Fara e kultivarëve duke përfshirë edhe kultivarët standard dorëzohen në DPMB – Seksionin e farës në gjendje të pa trajtuar me pesticide. Institucioni i autorizuar është i obliguar të kryej trajtimin e farës të të gjithë kultivarëve me pesticide të njëjta, duke përfshirë edhe kultivarët standard

3. Kualiteti i farës duhet të jetë sipas kushteve të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ sa i përket kërkesave bazë për kualitet, paketim dhe deklarim të farës së kulturave bujqësore të përcaktuara me Udhëzimi Administrativ Nr.04/ 2003 Për tregtimin e Farërave në Kosovë.

#### **Neni 6**

Parashtruesi i kërkesës duhet të vë në dispozicion të dhënat e farës sa i përket:

- a) masës së 1000 farave (g),
- b) pastërtisë së farës (%),
- c) mbirjes së farës (%) dhe
- d) normës së farës për mbjellje - numri i farave të mbira/m<sup>2</sup>.

#### **Neni 7**

Hulumtimi i kultivarëve bëhet në fushat testuese të cilat bëhen në rajone me veçori të ndryshme klimatike dhe pedologjike.

#### **Neni 8**

#### **Hulumtimet në Fushat Testuese**

Fushat testuese mbillen sipas rastit, planit më të përshtatshëm testues, duke marrë në konsideratë numrin e kultivarëve të paraqitura për hulumtime, me qëllim të vlerësimit sa më të mirë të tyre.

### **Neni 9**

Madhësia e ngastrave testuese do të jetë 10 m<sup>2</sup>, të cilën e përbëjnë 8 rende me gjatësi 10 m, me distancë në mes rendeve prej 12,5 cm. Distanca në mes ngastrave brenda përsëritjeve do të jetë 50 cm, ndërkaq në mes të përsëritjeve 2m.

### **Neni 10**

Rreth çdo fushe testuese vendoset brezi mbrojtës i mbjellur kultivari më të hershëm, i cili do të shërbej për marrjen e mostrave për përcaktimin e lagështisë në kokërr në bazë të cilit do të përcaktohet afati i drejtë për korrjen e kultivarëve testues.

### **Neni 11**

1. Gjatë tërë kohës sa zgjat testimi i një kultivari në fushat testuese dhe në laboratorë krahasimi bëhet me të njëjtin kultivar dëshmues apo standard.
2. Kultivari standard është kultivari i cili është më i njohuri në vendin tonë, i cili për nga vetitë e tija biologjike dhe ekonomike ka vlerën më të lartë për qëllimin për të cilën testohen kultivari i ri. Kultivarin standard e përcakton organi kompetent për njohjen e kultivarëve të kulturave lavërtari.

### **Neni 12**

Parashtruesi i kërkesës ka të drejtë gjatë periudhës së vegetacionit t'i vizitoj fushat testuese dhe të informohet për to.

### **Neni 13**

## **Vrojtimet gjatë vegetacionit**

1. Gjatë vegetacionit përcaktohen këto të dhëna:
  - a) data e mbjelljes,
  - b) data e mbirjes - 50% të bimëve të mbira,
  - c) numri i bimëve të mbira për 1 m<sup>2</sup>,
  - d) përqindja e dëmtimit nga ngricat, te kultivarët dimërorë,
  - e) kallisja - data kur 50% e bimëve kanë kallëzuar,
  - f) lartësia e bimëve në cm – nga baza deri te maja e kallirit - mesatarja e matjeve nga 10 bimë në secilën përsëritje,
  - g) shtrirja deri në fazën e kallisjes si dhe në fazën e pjekjes qumështore sipas datave, nëse është shkak i veçorive të kultivarit,
  - h) te kategorizimi i qëndrueshmërisë ndaj shtrirjes në kushtet fushore të përdoret shkalla prej 1 deri 9, në pajtim me udhëzimin për vrojtimit fushore gjatë vegetacionit. Te shtrirjet e larta është e nevojshme që edhe në formë teksti të shpjegohen shkaktarët e kësaj dukurie.
  - i) dëmtimet nga shpezët, mbirja e kokrrave në kalinj dhe humbjet e kombinuara,
  - j) data e pjekjes së plotë dhe data e korrjes-shirjes.
2. Shkallët për vrojtimit dhe mënyra e vlerësimit nga paragrafi 1 pika 8 të këtij neni do të përcaktohen me Udhëzimin Administrativ për vrojtimit gjatë vegetacionit.

### **Neni 14**

Në të gjitha fushat testuese kryhet mbrojtja nga dëmtuesit dhe barojat e këqija me preparate – pesticide adekuate sipas praktikave të rëndomta prodhuese.

## Neni 15

1. Me qëllim të përcjelljes së rezistencës respektivisht qëndrueshmërisë së kultivarëve ndaj sëmundjeve më të rëndësishme në Kosovë, në kushtet natyrore të infeksionit gjatë hulumtimit të kultivarëve përcillet shfaqja dhe vlerësohet intensiteti i prekjës nga këto sëmundje:

### **I. Te gruri**

- a) Ndryshku i verdhë i grurit, *Puccinia striiformis* f. sp. *tritici*,
- b) Ndryshku i portokalltë i grurit, *Puccinia recondita* f. sp. *tritici*,
- c) Ndryshku i zi i grurit, *Puccinia graminis* f. sp. *tritici*,
- d) Septorioza e grurit, *Septoria* spp.,
- e) Kalbëzimi i kallirit, *Fusarium* spp.,
- f) Hiri i grurit, *Erysiphe graminis* f. sp. *tritici*,

### **II. Te elbi**

- a) Hiri, *Erysiphe graminis* f. sp. *hordei*,
- b) Ndryshku i zi, *Puccinia graminis* f. sp. *hordei*,
- c) Ndryshku i verdhë, *Puccinia striiformis* f. sp. *hordei*,
- d) Ndryshku i kaftë i elbit, *Puccinia hordei*,
- e) Njolloosja e elbit, *Pyrenophora graminea*,
- f) Njolloosja rrjetore e elbit, *Pyrenophora teres*,
- g) Bloza e elbit, *Ustilago nuda*,
- h) Njolloosja e gjetheve të elbit, *Rhynchosporium secalis*.

### **III. Te thekra**

- a) Ndryshku ngjyrë kafeje, *Puccinia dispersa*,
- b) Ndryshku i zi, *Puccinia graminis*,
- c) Njolloosja e gjetheve, *Septoria* spp.,
- d) Hiri, *Erysiphe graminis*.

### **IV. Te tritikalet**

- a) Njolloosja e kaftë e gjetheve, *Septoria* spp.,
- b) Hiri, *Erysiphe graminis*.

### **V. Te tërshëra**

- a) Ndryshku i portokalltë i tërshërës, *Puccinia coronata*,
- b) Ndryshku i zi i tërshërës, *Puccinia graminis* f. sp. *avenae*,
- c) Hiri, *Erysiphe graminis* f. sp. *avenae*.

2. Nëse vërehet shfaqja e sëmundjeve dhe dëmtuesve tjerë, duhet shënuar kohën e shfaqjes dhe intensitetin e sulmit, e sipas nevojës edhe përqindjen e dëmtimit përkatësisht zvogëlimin e rendimentit të kokrrës.

3. Intensiteti i sulmit të sëmundjes vlerësohet nga eksperti i institucionit përgjegjës testues në të gjitha ngastrat eksperimentale sipas shkallës së caktuar e cila gjendet në udhëzimin për vrojtimit gjatë vegjetacionit.

## Neni 16

1. Korrja e secilës ngastër bëhet me autokombajnë, brenda një dite për secilin kultivar në të gjitha përsëritjet, në fazën e pjekurisë fiziologjike, me rreth 14% të lagështisë në kokërr te kultivari në brezin mbrojtës.

2. Gjatë korrjes në secilën ngastër përcaktohet rendimenti i kokrrës, masa hektolitare dhe lagështia e kokrrës.

## Neni 17

### Hulumtimet në Laborator

1. Analizat kimike-teknologjike kryhen në laborator, në mostrën mesatare prej 6 kg.
2. Mostrat merren:
  1. për grurin dimërorë dhe pranverorë në dy lokacione testuese,
  2. për elbin dimërorë dhe pranverorë, thekër, tritikale dhe tërshërë nga dy lokacionet testuese.

## Neni 18

1. Në mostrën mesatare të grurit dimërorë dhe atij pranverorë kryhen këto analiza:

### I. Gruri (*Triticum aestivum*)

#### 1.2 Vetit fizike të kokrrës:

- a) Pesha hektolitare e gririt të pastër (kg/hl),
- b) Pesha e 1000 kokrrave (g )
- c) Qelqëzimi ( %),
- d) Madhësia e kokrrave (2,8; 2,5; 2,2 i 2,0 mm).

#### 1.2 Vetit kimike – teknologjike të kokrrës dhe miellit:

- a) Proteinat ( %),
- b) Vlera e sedimentimit,
- c) Miellzimi i përgjithshëm ( %),
- d) Përmbajtja e ngjitësit të lagësht ( %),
- e) Përmbajtja e ngjitësit të thatë ( %),

#### 1.3 Farinogrami:

- a) Aftësia thithëse e ujit ( % në 13% lagështi të miellit),
- b) Koha e ardhjes së brumit (min.),
- c) Stabiliteti (min.),
- d) Shkalla e zbutjes së brumit (FJ),
- e) Kualiteti i farinogramit dhe numri i grupeve sipas cilësisë,
- f) Grupa teknologjike

#### 1.4 Ekstenzogrami:

- a) Energjia në 135 min. (cm<sup>2</sup>)
- b) Rezistenca ndaj tërheqjes (EJ),
- c) Elasticiteti (mm),
- d) Raporti i rezistencës së tërheqjes/elasticitet (O/R).

#### 1.5 Amilogrami,

#### 1.6 Rezultatet e pjekjes provuese të bukës:

- a) Redimenti i bukës (g/100 g miell),
- b) vëllimi i bukës (ml/100 g miell),
- c) Vlera numerike e tulit të bukës (VBS),
- d) Vetitë e tulit të bukës - elasticiteti, uniformiteti i poreve, struktura e murreve të poreve.

### II. Gruri (*Triticum durum*)

#### 1.7 Vetit fizike të kokrrës:

- a) Pesha hektolitare e gririt të pastër (kg/hl),
- b) Pesha e 1000 kokrrave (g )
- c) Qelqëzimi ( %),
- d) Madhësia e kokrrave (2,8; 2,5; 2,2 i 2,0 mm).

#### 1.8 Vetit kimike-teknologjike të kokrrës:

- a) Përmbajtja e hirit (% në m.th.<sup>1</sup>),
  - b) Përmbajtja e proteinave (% në m.th),
  - c) Numri i ramjes sipas Hagbergut (sek.).
- 1.9 Vetit kimike- teknologjike të thërrmijave:
- a) Përmbajtja e hirit (% në m.th.),
  - b) Përmbajtja e proteinave (% në m.th),
  - c) Pigmenti i verdhë (mg/kg).
- 1.10 Farinogrami (absorbimi: 31,5% H<sub>2</sub>O):
- a) Koha e formimit të thërrmijave (min.),
  - b) Konsistenca maksimale (F,J),
  - c) Toleranca në konsistencën maksimale (min.),
  - d) Gjerësia e lakores 5' pas konsistencës maksimale -min.
2. Në mostrën mesatare të kokrrës së elbit do të kryhen këto analiza:
- I. Për elbin e birrës**
- a) Përmbajtja e kokrrave,
  - b) Përmbajtja e proteinave,
  - c) Analiza mekanike,
  - d) Analiza fiziologjike,
  - e) Analiza kimike,
  - f) Analiza e ëmbëltuesve.
- II. Për kualitet të ushqimit për kafshë**
- a) Përmbajtja e kokrrave,
  - b) Përmbajtja e proteinave,
  - c) Proteinat e përgjithshme (%),
  - d) Yndyrat (%),
  - e) Celuloza (%),
  - f) NET (%),
  - g) Materiet minerale (%).
3. Në mostrën mesatare të thekrës dimërore dhe pranverore, tritikaleve dhe tërshërës kryhen këto analiza si:

<b>Analiza</b>	<b>Thekra</b>	<b>Triticale</b>	<b>Tërshëra</b>
Materia e thatë (%)	+	+	+
Materia organike (% në m.th)	+	+	+
BEM	-	-	+
Proteinat (% në m.th)	+	+	+
Yndyrat (% në m.th)	+	+	+
Celuloza (% në m.th)	+	+	+
Materiet minerale (% në m.th)	+	+	+
Masa e 1000 farave (g)	+	+	+
Masa hektolitare (kg/hl)	+	+	+

## Neni 19

### Analiza statistikore e rezultateve të hulumtimeve testuese

Për analizën statistikore të rezultateve të fushave testuese përdoret analiza e varijsansës dhe testet përkatëse për testimin e varijsansës në mes të vlerave mesatare F-testi, t-testi,

me  $P=0.05$  dhe  $P=0.01$ ). Të dhënat përpunohen sipas lokaliteteve dhe viteve të hulumtimit, si dhe kalkulohet koeficienti i variacionit.

#### **Neni 20**

Përmes Analizës së varijansës përpunohen veçoritë: rendimenti i kokrrës në kg/he me 14% lagështia e kokrrës, kurse veçoritë tjera relevante për njohje tregohen me vlerat mesatare, vargut maksimumin – minimumin dhe tjera mesatare, varësisht nga natyra e të dhënave në dispozicion.

#### **Neni 21**

##### **Rezultatet e hulumtimit**

Rezultatet periodike, vjetore dhe përfundimtare dy vjeçare të hulumtimit nga fushat testuese dhe laboratorike, varësisht nga lloji i kulturës bujqësore i prezantohen Seksionit të farës.

#### **Neni 22**

##### **Publikimi**

Rezultatet e hulumtimit nga fushat testuese dhe laboratorike publikohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

#### **Neni 23**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë 20.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi

---